

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË KOMUNËN PEZË, TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Komunën Pezë, Tiranë, me objekt: “Mbi Vlerësimin e aktivitetit ekonomik-financiar, zbatimin e Planit Rregullues të Përgjithshëm, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimit të aseteve, vlerësimi për shitje të trojeve nën objekt, shitjen e trojeve, legalizimin e shtesave në ndërtime, dhënien me qira të objekteve pronë publike, masat për mbrojtjen e mjedisit, vlerësimi i Auditit të brendshëm “ dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.8 , datë 26.01.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 332/5, datë 26.01.2012, dërguar **z. Enver Dorzi**, Kryetar i komunës, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të përgatitet dhe të paraqitet në Këshillin e Komunës, “Rregullorja e Brendshme e Komunës”, ku të pasqyrohet struktura organike, numri i punonjesve të administratës, vendet e punës, arsimi dhe kualifikimi profesional, detyrat funksionale dhe të drejtat e tyre. Për punonjësit e tjerë të shërbimeve, të përcaktohen normat e punës dhe pagesa përkatëse, sipas aktiviteteve për të cilat ka nevojë Komuna, bazuar në aktet ligjore në fuqi.

Deri me 31.03.2012

2. Këshilli i Komunës, vendimet t’i marrë bazuar në projekt-vendimet dhe relacionet shpjeguese të paraqitura zyrtarisht nga organet e ngarkuara posaçërisht, dhe jo siç është vepruar deri tani, në mungesë të këtyre dokumenteve.

Vazhdimisht

3. Të ngrihet një Komision me specialist të fushës, për verifikimin dhe marrjen në dorëzim të punimeve të kryera dhe ta paguara, i cili të nxjerrë përgjegjësinë materiale, në këto objekte ;

- rikonstruksion rruge Gjysylkaje, me vlerë 208.435 lekë,
- rikonstruksion rruge Pezë-Grece, me vlerë 477.000 lekë,
- rikonstruksion rruge Varosh – Pezë, me vlerë 465.000 lekë,
- rikonstruksion Kopshti Pezë, me vlerë 196.680 lekë,
- rikonstruksion kanalizime të UZ, lagjia, Mere Pezë, me vlerë 400.000 lekë.

Deri me 31.03.2012

4. Të ngrihet një grup pune me specialist të fushës, për bërjen e hartës së pastrimit të territorit, përcaktimin e sipërfaqeve të pastrimit, volumet e mbeturinave, sipas numrit të banoreve e bizneseve, pikat e vendosjes së kazanëve dhe pikën e hedhjes së mbeturinave, dhe në bazë të të dhënave faktike që do të rezultojnë, të kryhet prokurimi i fondeve të pastrimit për vitin 2012.

Deri me 31.03.2012

5. Të kontaktohet zyrtarisht me subjektin [REDAKTUAR], për ndreqjen me mirëkuptim të mangësive ligjore, të konstatuara në kontratat e qirasë të lidhura ndërmjet saj dhe ish Këshillit të Rrethit Tiranë, për një afat 99 vjet, për pasurinë me numër 24/18, ngjitur me lumin Erzen, dhe nëse nuk jep bashkëpunimin, Komuna si palë e interesuar dhe pronare e sipërfaqes objekt i kontratave, të kërkojë nga organet gjyqësore, prishjen e kontratave.

Menjëherë

6. Nga Kryetari i Bashkisë, të ngrihen grupet e punës, për verifikimin dhe hipotekimin e 240 pasurive të paluajtshme, që i kanë kaluar Komunës me vendim të Këshillit të Ministrave nr.528, datë 01.05.2008, si dhe të kërkojë nga Këshilli i Ministrave shpjegime zyrtare për 338 prona që janë hequr nga lista paraprake e miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak, nr 43, datë 30.07.2009.

Deri me 31.03.2012

7. Të kërkohet zyrtarisht, Këshillit të Qarkut Tiranë, përcaktimi i vijave kufizuese të Komunës Pezë, për të shmangur problemet e keqadministrimit dhe të mungesës së kontrollit të territorit, si pasojë e mos ndarjes së mënyrë të qartë të territorit me Komunën Ndroq.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të kërkohet në rrugë ligjore dëmi i shkaktuar buxhetit të Bashkisë, në vlerën **3.858.990 lekë** si më poshtë :

1, vlera **168.250 lekë**, nga [REDAKTUAR] përfituar pa drejtësisht, për punime të pa kryera, në objektin “Kanalizim i Ujrave të Zeza Kodrasenaj Pezë-Helmes”.

2, vlera **50.740 lekë**, nga subjekti [REDAKTUAR] përfituar pa drejtësisht, për punime të pa kryera, në objektin “Hapje pusi për ujë të pijshem Pezë e Madhe”.

3, vlera **3.640.000 lekë**, nga subjekti [REDAKTUAR] përfituar pa drejtësisht, nga përdorimi i një sipërfaqeje trualli prej 6500 m², pa paguar qira, sipas tarifave shtetërore (ky qiramarrës, për truallin me numër pasurie 24/18, ka paguar qira për 20.000 m², por në bazë të regjistrit hipotekor të pasurive të paluajtshme, sipërfaqja e këtij trualli është 26.500 m².

Menjëherë

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Pal Gjoni dhe Ervehe Çunami. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT